



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 22 / 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 11.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 09.01.2011, nga subjekti politik LVV, me te cilën pretendohet se më datë 09.01.2011, në ora 12:10, në hyrjen e shkollës “Isa Boletini” në fshatin Isniq Komuna e Deçanit ka qëndruar kandidati për deputet Shkelzen Jusaj nga subjekti politik AAK. Më këtë parashtruesi i ankesës konsideron se është bërë shkelje e nenit 7 par.1 pika (b) e Rregullës Zgjedhore 13/2009. Parashtruesi i ankesës kërkon që të merren masat ligjore nga PZAP-i.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se pretendimet nga parashtruesi i ankesës se janë bërë shkeljet e potencuar në ankesë janë të pabazuara nga shkak se nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë nga ana kandidati të subjektit politik AAK. Për më tepër, parashtruesi i ankesës nuk ka sqaruar se sa ka qenë kohëzgjatja e qëndrimit të supozuar të kandidatit për deputet pranë oborrit të qendrës së votimit, si dhe cili ka qenë niveli i ndikimit të mundshëm i pranisë së tij në procesin e votimit. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 22/2011 më datën 11.01.2011

